

**Autor i disa veprave nga albanologjia. Bisedë me dr. Robert Elsin, studiues,  
përkthyes e albanolog kanadez, i cili jeton e vepron në Bon të RFGj.**

*Dr. Robert Elsi (Robert Elsie) tashmë njihet si përkthyes, albanolog e studiues, i cili me veprat “Antologji e lirikës shqipe” dhe “Leksikoni i letërsisë shqipe” ka arritur të radhitet ndër të interesuarit e huaj që merren me mjaft përkushtim me çështjet albanologjike. Sivjet Elsi për të tretën herë mori pjesë edhe në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Kosovës. Me të nisëm bisedën gjatë kohës së seminarit, kurse këto ditë na u përgjigj edhe në disa pyetje që ia shtruam.*

[ShG]: Shoku Elsi, do të donim të dinim më për së afërmi diçka për biografinë tuaj.

[RE]: U lindi në qershor 1950 në Vankuver të Kanadasë, ku kreu një pjesë të shkollimit, pastaj vazhdoi shkollën e tretë në Universitetin e Lirë të Berlinit, kurse tezën e doktoraturës e kam realizuar në gjuhësinë krahasimtare më 1978 në Universitetin e Bonit me titull “Pozita e britonishtes, analizë sinkronike dhe diakronike e marrëdhënieve gjenetike në fjalorin themelor të keltishtes britonike.” Studime specialistike kam bërë në Institutin e Studimeve të Avancuara në Dublin dhe në institucione të tjera, ndërsa më 1980-1982 kam qenë mësimdhënës në Universitetin e Bonit. Tash punoj në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë në Bon.

[ShG]: Kur filluat të interesoheni rreth albanologjisë?

[RE]: Çështjet albanologjike më interesojnë që nga viti 1979, prandaj kam bërë edhe disa udhëtime me qëllim që t’i thelloj njohuritë rreth këtyre problemeve. Sivjet në Prishtinë ndoqa për të tretën herë Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Këtu kontaktoj me albanologë të jashtëm dhe me ata kosovarë, kështu që më jepen mundësi për t’i pasuruar njohuritë e mia rreth shumë problemeve albanologjike.

[ShG]: Keni publikuar një varg studimesh në shumë revista, por edhe të mëvetësishme. Na intereson qëllimi juaj rreth angazhimit në fushën e albanologjisë.

[RE]: Vepra ime në fushën e albanologjisë ka për qëllim të përhapë njohuri për letërsinë dhe kulturën shqiptare në botë. Letërsia shqipe është mjaft e panjohur, do të thosha, në botë, sepse kanë munguar përkthimet nga specialistët. Ata që nuk e dinë shqipen s’kanë shumë mundësi të informohen rreth letërsisë dhe kulturës shqiptare. Mbase veprat e mia “Leksikoni i letërsisë shqipe” dhe “Antologjia e lirikës shqipe” mund të kuptohen si hyrje për të huajt.

[ShG]: Më konkretisht për veprat e kërkimit tuaja në fushën e albanologjisë?

[RE]: Unë i kam disa vepra albanologjike: disa të botuara dhe disa ende të papublikuara. Kam botuar “Leksikonin e Letërsisë Shqipe” (*Dictionary of Albanian Literature*,

Greenwood Press, New York, Westport, London 1986), “Migjeni: Vargjet e Lira” (*Migjeni: Freie Verse. Gedichte aus Albanien*. Schulz-Kirchner Verlag, Idstein) në RFGj, disa artikuj dhe kritika letrare në revistat shkencore, ndër të tjera, në *Zeitschrift für Balkanologie* dhe *World Literature Today*. Ndërkaq, sivjet pres të dalë antologjia e poezisë shqipe me titull “Nje Shqiponjë e Arratisur Fluturon” (*An Elusive Eagle Soars: Anthology of Albanian Poetry*, Forest Books, London).

[ShG]: Në botimin gjermanisht të “Vargjeve të lira” të Migjenit keni bërë dhe një shënim.

[RE]: Aty është një shënim i shkurtër ku, pos të tjerash, kam theksuar: “Migjeni qe një intelektual i ri evropian i viteve '30 nga Shqipëria. Me të fillon lirika bashkëkohore shqiptare. Qe njëri ndër shkrimtarët e parë që u larguan nga tradita e romantizmit nacional në lirikën shqiptare. Në veprën e tij shprehte frustracionet e veta, shpresën, dhembjen, nostalgjinë dhe, para së gjithash, zemërimin për vuajtjen e njerëzve rreth tij. 26 vjeçari vdiq nga TBC-ja. I përket rrethit të poetëve më të lexuar shqiptarë.”

[ShG]: Edhe “Leksikoni i letërsisë shqipe” ka rëndësi të veçantë për njohjen dhe popullarizimin e letërsisë shqipe.

[RE]: Ky libër doli vjet në disa mijëra kopjesh. Përmes tij kam pasur për qëllim që lexuesin e interesuar të njoh me disa të dhëna elementare për letërsinë shqiptare, e cila, siç thashë më lartë, njihet fare pak në Perëndim. Ky qe pa dyshim fakti që më nxiti t’i rrekem një pune të tillë. Pos për shkrimtarët, këtu jam përpjekur të jap edhe ca të dhëna për klubet, shoqëritë, revistat, veprat letrare etj., të cilat ndikuan në zhvillimin e krijimtarisë letrare. Letërsia këtu është parë në mënyrë integrale: prej fillimeve e deri sot, ku janë përfshirë rreth pesëqind shkrimtarë. Në leksikon ka mjaft të dhëna për autorët e përfshirë.

[ShG]: Me siguri, gjatë hartimit të këtij leksikoni do të keni hasur edhe në vështirësi të natyrave të ndryshme.

[RE]: Sigurimi i biografive, i bibliografive, sistemimi etj., pa dyshim, qenë ndër vështirësitë që do t’i dilnin secilit studiues e hartues të botimeve çfarë pata pretendime në këtë leksikon. Po ashtu problem qe edhe zgjedhja e shkrimtarëve, kriteret rreth tyre, prandaj në këtë dhe plane të tjera mund të ketë lëshime, që mendoj se në të ardhmen në ndonjë botim tjetër duhen evituar.

[ShG]: Çka po punoni, çka keni në plan më tej?

[RE]: Aktualisht po e filloj një punë rreth letërsisë së vjetër shqipe. Pastaj ndoshta do t’i bëj disa përkthime nga shqipja në gjuhën angleze.

Bisedoi: Shyqri Galica.

[botuar në / published in: gazeta *Rilindja*, Prishtinë, 11 nëntor/November 1987.]